

Menaxhimi Strategjik

Kapitulli 2

Krijimi i filozofisë dhe misionit të kompanisë

Naim Ismajli

Hyrje

- Koncepti i planifikimit strategjik
- Procesi i planifikimit strategjik
- Elementet e planifikimit strategjik
- Përpilimi i planit strategjik
- Zbatimi i planit
- Vlerësimi dhe Monitorimi


Pse bëhet planifikimi strategjik?

- Planifikimi strategjik është mjet për të menaxhuar ndryshimet e nevojshme
- Tregon: ku jemi, ku do të shkojmë dhe si
- Të gjithë punojmë për të shkuar drejt një caku të njejtë
- Mundëson të masim suksesin tonë
- Baraspeshon të menduarit në afat të shkurtë dhe afat të gjatë
- Bëhemi proaktiv në vend se reaktiv

Thënie:

- “Nëse gjithëmonë e bëni atë që e keni bërë gjithëmonë, atëherë gjithëmonë do të fitoni atë që gjithëmonë e keni fituar.” (Anonime)
- “Nëse nuk planifikoni, atëherë ju planifikoni të dështoni” (B. Franklin)

RRUGA DREJT SUKSESIT!!



Misioni

- Tregon arsyen e ekzistencës së institucionit
- Tregon çfarë qëllimi/e kemi?
- Në çfarë mënyre do ta realizojmë
- Duhet të jetë përgjegjje në nevojat e atyre të cilëve u shërben institucioni(biznesi)
- Duhet të jetë brenda mandatit të institucionit
- Identifikon klientët (konsumatorët)
- Përmban vlerat të cilat i udhëheqin njerëzit e institucionit

Shembulli 1.

- “Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit të kosovarëve duke vlerësuar gjendjen dhe nevojat shëndetësore, duke zhvilluar politikat dhe prioritetet, për të siguruar që shteti do të përgjegjet si duhet.”

Shembulli 2.

- “Zhvillimi i një sistemi të efektshëm të arsimit të lartë që i kontribuon ngritjes së mirëqenies së shoqërisë kosovare duke ofruar një arsimim dhe kërkim shkencor të cilësisë së lartë, me mundësi të barabarta për të gjithë, në pajtim me vlerat e lirisë, demokracisë dhe të diversitetit.”

Vlerat

- Integriteti
- Progresi
- Gjithëpërfshirja
- Përgjegjshmëria
- Profesionalizmi
- Barazia
- Punojmë në shërbim të njerëzve

Vizioni

- Një përshkrim i gjendjes ideale të organizatës suaj në të ardhmen
- Një ëndërr e përbashkët mbi ndryshimin që do të bëni në shoqëri
- Duhet të jetë atraktiv, unik dhe inspirues

Shembulli 1.

“Deri në fund të kësaj dekade, ne do ta dërgojmë njeriun në Hënë.”

John Fitzgerald Kennedy

Shembulli 2:

“Të gjithë njerëzit do të kenë qasje në një kujdes cilësor shëndetësor, pavarësisht nga mundësia e pagesës”

“Në qytetarët e Kosovës dëshirojmë të krijojmë një shoqëri të shëndoshë dhe të sigurtë, me njerëz të arsimuar dhe ekonomi të zhvilluar – ku ekziston e ardhmja dhe shpresa për të gjithë”

Perkufizimi I Filozofise se organizates

Filozofia e organizates perfshin vlerat, besimet dhe udhezimet per menyren ne te cilen organizata do te zhvilloje biznesin e saj


- ❑ Çdo organizat, me qellim qe te mbijetoj dhe te arrij suksese duhet te kete disa vlera besime ne te cilat mbeshtet politikat dhe veprimet
- ❑ Faktor I vetem me I rendesishem I suksesit te organizates eshte mbeshtetja ne keto besime
- ❑ Ne raste se organizata ballapaqohet me sfida dhe kriza ne tregun e konkurences e vetmja qe nuk duhet te ndryshohet eshte besimi dhe filozofia e saje

Perkufizimi I Filozofise se IBM

- ❖ *Rrespekt per individin, Ky eshte nje koncept I thjeshte, por qe ne I kushtojme pjesen me te madhe te kohes*
- ❖ *Ne deshirojme te krijojme sherbimin me te mire per konsumator, krahasuar me te gjitha kompanite tjera*

Qëllimet

- Paraqesin rezultate përfundimtare që tregojnë një përfitim për qytetarët
- Tregojnë çfarë të mire publike dëshiron të arrijë institucioni juaj
- Realizimi i tyre ndihmon misionin
- Zakonisht 3 deri në 5
- Janë në harmoni me mandatin
- Në harmoni me programin e qeverisë
- Qëllimet duket të kategorizohen sipas prioriteteve



Shembuj:

- “Zvogëlimi i mortalitetit të fëmijëve”
- “Rritja e sigurisë në trafik”
- “Zvogëlimi i ndotjes së ambientit”
- “Lufta kundër korrupsionit”
- “Zvogëlimi i rasteve në asistencë sociale”
- “Krijimi i një shërbimi civil profesional dhe të paanshëm politikisht”

Objektivat

- Tregojnë se cili është sukseesi apo impakti specifik i programit të institucionit
- Realizimi i tyre mundëson realizimin e *qëllimit*
- Tregojnë se çka saktësisht do të arrihet, sa do të arrihet (sasia), kur do të arrihet (koha) dhe nga cila njësi organizative (përgjegjësia)
- Tregojnë se deri në ç'masë janë plotësuar nevojat e klientëve

Karakteristikat e objektivave

- Janë **SMART** (ang.) *SMARTER*
- **Specific** – specifike
- **Measurable** – të matshme
- **Aggressive but Attainable** – të arritshme
- **Result-oriented** – paraqesin rezultate
- **Time-bound** – të lidhura me kohë të caktuar
- *Ekologjik*
- *Reversibil (kthyes)*

Shembuj:

- “Deri në 2015, të zvogëlohet numri i viktimave në aksidentet e trafikut nga 5500 në më pak se 4000 gjatë një viti.”
- “Brenda dy vjetëve të ardhshme të rritet përqindja e punësimit të femrave në administratën publike nga 30% në 40%”
- “Deri në dhjetor të vitit 2014, të hartohet Urdhëresa Administrative për Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare”
- Deri në vitin 2014, të mundësohet qasja për personat me aftësi të kufizuar në së paku 50% të ndërtesave publike, nga 45% sa është tash.”
- ***Vlerësoni a janë SMART?***

Matësit

- Matësit e objektivave janë informata të kuantifikueshme që tregojnë se në ç'masë po realizohet objektiva

Shembuj:

- “Përqindja femrave të punësuar në administratën publike”
- “Numri i përgjithshëm i viktimave nga aksidentet e trafikut gjatë një viti”
- “Përqindja e papunësisë në Kosovë”

Aktivitetet

- Janë qasjet që zgjedhë institucioni për t'i arritur objektivat
- Paraqesin mënyren se si do të arrihet objektiva
- Kur përcaktohen aktivitetet duhet të diskutohen disa alternativa dhe të analizohen sipas kriterëve si vijon:
 - Sa kushton? Cili është përfitimi? (cost-benefit)
 - Çfarë është impakti në realizimin e objektivës
 - A ka organizata kapacitet dhe burime për ta implementuar atë (buxheti, kapaciteti njerëzor profesional, koha)

Shembuj:

O1: Deri në 2015, të zvogëlohet numri i viktimave në aksidentet e trafikut nga 5500 në më pak se 4000 gjatë një viti

a1: Rritja e dënimeve për tejkalim të shpejtësisë

a2: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore

O2: Brenda dy vjetëve të ardhshme të rritet përqindja e punësimit të femrave në administratën publike nga 30% në 40%

a1: Organizimi i trajnimeve profesionale pa pagesë për femra

a2: Dhënia e bursave për shkollim të lartë në fushën e administratës publike

Plani i punës

- Cilët hapa do të ndërmerren për të realizuar strategjinë
- Detalizoni detyrat
- Kush është përgjegjës
- Kush është mbikëqyrës
- Kur do të realizohet detyra
- Çfarë burimesh nevojiten
- Cakto periodën e vlerësimit (p. sh. në baza tremujore)

Alokimi i Buxhetit

- Alokimi I buxhetit synon që të mundësoj një ndarje të duhur të burimeve buxhetore
- Planifikimi strategjik mundëson kategorizimin e prioriteteve
- Burimet do të drejtohen në ato prioritete të cilat do të arrijnë qëllimet e organizatës në mënyre efektive dhe me efijencë.

Legjislacioni dhe plani strategjik

- Legjislacioni rregullon mandatin e institucionit
- Hartimi i legjislacionit të ri mund të jetë pjesë e planit strategjik. Kjo duhet të bëhet në harmoni me programin e Qeverisë
- Legjislacioni i ri mund të hartohet edhe pa inputin e agjensisë/departamentit tuaj, dhe mund të afektoj planin strategjik.
- Informohuni dhe jini të përgatitur

RRUGA DREJT SUKSESIT!!

